Ligji Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë dhe Rregullorja Nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, në të cilën ju jeni bazuar, nuk janë në fuqi, pasi me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 5 janar 2023, është shfuqizuar, ashtu siç parashihet edhe në nenin 45, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Po ashtu, edhe Nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, në të cilën ju jeni bazuar, është e shfuqizuar me rastin e hyrjes në fuqi të rregullores (QRK) 08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik, e cila ka hyrë në fuqi më datë 6 shkurt 2023.

Andaj, duke marrë parasysh se ligji dhe rregullorja në të cilën ju jeni bazuar në kërkesën tuaj me Nr. Prot. 5937, e datës 1.11.2023, nuk janë në fuqi për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit të ri dhe të rregullores së re, të cilat e rregullojnë çështjen e kompensimit të pagave dhe të kompensimeve të tjera, kërkesa juaj nuk mund të aprovohet dhe e njëjta refuzohet.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë në organet kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Z. Ibrahim Thaçi,
- Njësisë së Personelit,
- Arkivit.

Smajl Latifi  
  
**Kryetar i Komunës**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



|                                                                                                                                 |                              |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO<br>KOMUNA E RAHOVECI / MUNICIPALITY OF RAHOVEC<br>KRYETARI I KOMUNES / MUNICIPAL MAYOR |                              |
| Njësia Nr./Br./No. 020 Kabineti i Kryetarit të Komunës                                                                          |                              |
| Nr./Br./No. 3333                                                                                                                | Nr. i fletës ser./no. pg. 46 |
| Data/Datum/Dato 7 / 11 / 23                                                                                                     |                              |

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit në vreshta, i shkaktuar nga zjarri, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5691, e datës 9.10.2023, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues,
  - 1.2. Hasan Vuçitërna, anëtar,
  - 1.3. Veton Mustafa, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit në vreshta, i shkaktuar nga zjarri, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5691, e datës 9.10.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 14.11.2023.
5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR-së, dhe
- Arkivit.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



|                                                         |                           |
|---------------------------------------------------------|---------------------------|
| KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY OF RAHOVEC            |                           |
| KOMUNALNA UPRAVLA / MUNICIPALITY ADMINISTRATION         |                           |
| KRYETARI I KOMUNES / MUNICIPAL MAYOR                    |                           |
| Njësim Nr./Br./No. (Në Kabineti i Kryetarit të Komunës) |                           |
| Nr./Br./No. 3334                                        | No. ifaqshirës/no pag. 46 |
| Data/Datum/Date 7/11/23                                 |                           |

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22, paragrafi 1, pika 1.7, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Sejfullah Sejfullahut nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 5947, e datës 2.11.2023 për ndihmë financiare prej 980.00€ (nëntëqind e tetëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të botimit të librit me titull "Bëje ose vdis".
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Sejfullah Sejfullahu, si njëri nga shumë shkrimtarët dhe publicistët e Komunës së Rahovecit, ka marrë iniciativë për botimin e librit me titull "Bëje ose vdis", i cili përshkruan luftën e fundit në Kosovë, respektivisht në rajonin e Zonës së Pashtrikut, rezistencën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe martirizimin e qytetarëve civilë, të nxënësve, të arsimtarëve dhe të profesorëve.

Andaj, duke marrë parasysh se i lartpërmenduri e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve në lidhje me botimin e vëllimit të tij, është e domosdoshme ndihma financiare dhe përkrahja institucionale për mbulimin e shpenzimeve për botimin e këtij vëllimi me rëndësi për lexuesit.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### *Me vendim të njoftohen:*

- *Sejfullah Sejfullahu,*
- *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC  
Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës  
Nr./Br./No. 3335 Nr. ifaq/Besë/No. py. 46  
Data/Datum/Date 7.11.23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Nexhmie Hotit nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 5762, të datës 17.10.2023 për ndihmë financiare prej 200.00€ (dyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të këngës të vajzës së saj.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Nexhmie Hoti ka marrë iniciativë për realizimin e këngës për fëmijë për vajzën e saj, me të cilën do të marrë pjesë në festivalet dhe festat e fundvitit për programet për fëmijë.

Andaj, duke marrë parasysh se Komuna e Rahovecit është e përkushtuar në ruajtjen dhe promovimin e talenteve të reja, është e domosdoshme ndihma financiare dhe përkrahja institucionale për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e këtij projekti.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Me vendim të njoftohen:**

- Nexhmie Hoti,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KRYETARI I KOMUNES / PRESIDNIK OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR  
Nytis Nr./Bz./No 02/Kabineti i Kryetarit i Komunës  
Nr./Bz./No 3336 / Nr. ifaqillimit/No. p. 46  
Data/Date 7 / 11 23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa për punë shtesë dhe punë të paparapara, e Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 13, e datës 3.11.2023 dhe kërkesës së mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë me Nr. Prot. 5690, të datës 3.11.2023, në projektin "Ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe" me Nr. të Prokurimit 623-20-5659-5-2-1, në shumën prej 14,804.46€ (katërmëdhjetë mijë e tetëqind e katër euro e dyzet e gjashtë cent).
2. Ky vendim merret pasi është konstatuar nga Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë, dhe
- Arkivit.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Komuna e Rahovecit**

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-020, nenit 24 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2018 për Kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, dispozitave të neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komisionit Komunal për Kthim në Komunën e Rahovecit**

1. Me këtë vendim, themelohet Komisioni Komunal për Kthim në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje si në vijim:
  - 1.1. Lendrit Qeli, ZKKK - kryesues,
  - 1.2. Jeton Krasniqi – Arsim, anëtar,
  - 1.3. Etnik Popaj - Shëndetësi, anëtar,
  - 1.4. Goneta Mustafa – Punë dhe Mirëqenie Sociale, anëtare,
  - 1.5. Fadil Bugari - Shërbime Publike, anëtar,
  - 1.6. Selim Metkamberi - Planifikim dhe Urbanizëm, anëtar,
  - 1.7. Nazmi Krasniqi - Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtar,
  - 1.8. Përfaqësues i MKK-së, anëtar.
2. Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues për rastet si në vijim: Riparimet, ndërtimin, rindërtimin, materialin ndërtimor, pakot ushqimore, artikujt joushqimor, pakot higjienike, orenditë shtëpiake, lëndët djegëse për ngrohje, qiraja dhe alokimi i tokës me të drejtat e shfrytëzimit për rastet e veçanta, sipas Ligjit në fuqi për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
3. UNHCR-ja ka rolin këshillues në Komisionin Komunal për Kthim, si dhe është i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllime të monitorimit.
4. Komisioni Komunal për Kthim, mbledhet të paktën 1 (një) herë në muaj, si dhe me kërkesë nga ana e udhëheqësit të ZKKK-së, në konsultim me anëtarët e tjerë.
5. Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues, i cili propozon rastet për vendim të Komisioni Qendror në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
6. Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal për Kthim është 3 (tre)-vjeçar.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Forma e Nivëzimit të Kryetarit të Komunës  
Nr. 332 Nr. i Regjistrimit: 47  
Data: 8 / 11 / 23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvit", me Nr. prokurimi: 623-23-11935-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-071-2-3-6, të datës 7.11.2023, në këtë përbërje:
  - 1.1. Faik Thaqi, kryesues,
  - 1.2. Enise Dina, anëtare,
  - 1.3. Kosovare Gashi, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Dekorimi i qytetit të Rahovecit për fundvit", me Nr. prokurimi: 623-23-11935-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-071-2-3-6, të datës 7.11.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**

*Opština Oraovac / Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – President Opštine – Municipal Mayor**



346  
10.10.2023

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pikë 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndajjes së Subvencioneve me Nr.3427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Sakina Behluli** nga Rahoveci me Nr. Protokolli 06-553/01-0044612/23, e dt. 12.10.2023 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katerqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**Znj.Sakina Behluli** nga Rahoveci me datë 12.10.2023 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonë (lindje) pasi që me datë 06.10.2023 ka lindur vajzën në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.Sakina Behluli**, si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për fëmijën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

**Me vendim të njoftohen:**

- **Znj.Sakina Behluli nga Rahoveci,**
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

**Suraj Latifi**  
*Suraj Latifi*  
**Kryetari i Komunës**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahotec / Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Nr./Bz./No. 3351 Nr. i fsh./Bz./No. pg. 48  
Data/Datum/Date 13 / 11 / 2023  
RAHOVEC / ORAHOVEC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022 të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit të datës 3.11.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq", me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq"**

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të projektit dhe e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq", me numër të kontratës: 623-21-3119-5-1-1/C335.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore, që është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me Grupin e Operatorëve Ekonomikë "Mirusha Company" Sh.P.K.; "Globi - M.I" Sh.P.K., me adresë në Klinë (në vazhdim Furnizuesi), me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq" me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335 me Nr. Prot. 5077, të datës 24.11.2021.

Pas nënshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, situata ka ndryshuar, sepse artikujt të cilat janë objekt i punimeve sipas kësaj kontrate kanë pësuar ndryshime të mëdha në çmimin e furnizimit në treg.

Për këtë arsye, Grupi i Operatorëve Ekonomikë "Mirusha Company" Sh.P.K.; "Globi - M.I" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 5814, të datës 19.10.2023, të menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, të cilët janë caktuar me vendim të Zyrtarit

Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq" me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335, me arsyetimin, se çmimet e produkteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës në vitin 2018, kanë pësuar rritje të mëdha në vitin 2022, dhe me këtë rast është e pamundur kryerja e punimeve sipas kontratës.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës, i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim për ndërprerjen e kontratës me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq", me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të Grupit të Operatorëve Ekonomikë "Mirusha Company" Sh.P.K.; "Globi - M.I" Sh.P.K. me Nr. Prot. 5814, të datës 19.10.2023, si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sopniq" me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335, për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë për ndërtim në bursa ndërkombëtare, po ashtu edhe në Republikën e Kosovës, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, si dhe duke u bazuar në nenin 38 të kësaj kontrate në të është e paraparë "forca madhore" e cila është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 5077 të datës 24.11.2021 me titull "Lot I – Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sopniq" me numër të kontratës 623-21-3119-5-1-1/C335.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- *Zyra e Prokurimit,*
- *Menaxheri i Projektit,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC  
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 352 Nr. i fletës/Drat./No.pg 48

Data/Datum/Date 16/11/23

R. RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit në serra, të shkaktuar nga erërat e fuqishme, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5964, e datës 6.11.2023; 5972, e datës 6.11.2023; 5977, e datës 6.11.2023; 6004 e datës 7.11.2023 dhe 6055, e datës 10.11.2023, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues,
  - 1.2. Hasan Vuçitërna, anëtar,
  - 1.3. Veton Mustafa, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit në serra, të shkaktuar nga erërat e fuqishme, sipas kërkesës me Nr. Prot. 5964, e datës 6.11.2023; 5972, e datës 6.11.2023; 5977, e datës 6.11.2023; 6004, e datës 7.11.2023 dhe 6055, e datës 10.11.2023.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 24.11.2023.
5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR-së, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi  
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Nr. i Protokollit / No. 020 / Kryetari i Komunës  
Nr. i Dështimit / No. 3353 Nr. ifaq / Dështim / No. 48  
Data / Datum / Datë 14.11.2023  
Kryetari i Komunës

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Thirrjes publike për aplikim, me Nr. Prot. 5764, të datës 17.10.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike për aplikim, me Nr. Prot. 5764, të datës 17.10.2023, në këtë përbërje:
  - 1.1. Fidan Hoti, kryesues,
  - 1.2. Artan Asllani, anëtar,
  - 1.3. Veton Mustafa, anëtar,
  - 1.4. Egzon Thaqi, anëtar,
  - 1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projektpropozimeve të bizneseve që merren me artizanate, përpunues të metalit, të drurit dhe të ushqimeve tradicionale, sipas thirrjes publike për aplikim, të shpallur nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, me Nr. Prot. 5764, të datës 17.10.2023.
- Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në thirrjen publike për aplikim, të shpallur nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, me Nr. Prot. 5764, të datës 17.10.2023.
- Komisioni do të filloj punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfutësve.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DEZhT, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi  
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Bë./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Bë./No 3356 Nr. i Fax/Bë./No po 48  
Data/Datum/Data 16/11/23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për pranimin e lëndëve djegëse (dru) për nevojat e shkollave të Komunës së Rahovecit**

1. **Caktohet** komisioni për pranimin e lëndëve djegëse (dru) për nevojat e shkollave të Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024, në këtë përbërje:
  - 1.1. Shëdat Ukaj, kryesues,
  - 1.2. Luan Sharku, anëtar,
  - 1.3. Drejtori përkatës i shkollës.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin e lëndëve djegëse (dru) për nevojat e shkollave të Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në kontratën ekzistuese dhe legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:*

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Arsim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

OPŠTINA ORAHOVAC / KOMUNA RAHOVEC  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor  
Njësia Nr./Br./No 62 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 3358 Nr. ifaq/Br./nr/No pg 68  
Data/Datum/Date 16/11/23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me dru ahu për vitin shkollor 2023/2024", me numër të kontratës: 623-23-9790-1-1-1/C526, si në vijim:
  - 1.1. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: zyrtar për paga dhe shpenzime, në Drejtorinë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2. Avni Morina, drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
  - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
  - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
  - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
  - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
  - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (letëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
  - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
  - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
  - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
  - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
  - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
  - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
  - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
  - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
    - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
    - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
  6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*

  
Smail Latifi  
Kryetar i Komunës  
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3361 Nr. i faq./Br.nr./No. pg. 49

Data/Datum/Date 05/11/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 5587, e datës 26.9.2023 për ndihmë financiare prej 100.00€ (njëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m

[REDAKTUAR], vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KRYETARI I KOMUNES  
Njësia Nr./Br./No 92(Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 3362 Nr. i faq/Br./str./No pg 49  
Data/Tutur./Date 15 / 11 / 23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR], me Nr. Protokolli 5872, e datës 25.10.2023 për ndihmë financiare prej 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m

[REDAKTUAR] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E RAHOVECIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
Smajl Latifi  
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY RAHOVEC

Njësia Nr./Ille/No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Tit./No 3363 Nr. i ftoq./Brat./No. pg 49

Data/Date/Date 15/11/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] me Nr. Protokolli 5843, e datës 23.10.2023 për ndihmë financiare prej 100.00€ (njëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### Arsyetim

[REDAKTUAR] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KRYETARI I KOMUNES / MUNICIPAL MAYOR  
Smajl Latifi  
Kryetar i Komunës  
ORAHOVAC



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Bz./No 020 Kabineti i Kryetarit të Komunës  
Nr./Bz./No 3364 Nr. ifaq/Bzaz/No.pg 49  
Data/Datum/Date 15/11/23  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 5528, e datës 21.9.2023 për ndihmë financiare prej 100.00€ (njëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### A r s y e t i m

[REDAKTUAR] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY ORAHOVAC  
KRYETARI I KOMUNËS / PRESIDENT OF MUNICIPALITY / MAYOR

Nësisë Nr./Bc./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Ish./No 365 Nr. i fletës/Br. no. 19

Data/Datum/Date 15.11.23

RAHOVEC / ORAHOVAC

